



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpall:

FTESË PUBLIKE

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:
PËRKRAHJE ME FIDANE TË MJEDRËS DHE SISTEM TË UJITJES

Përfitues: 16 fermerë me nga 1250 €

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

1. *Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;*
2. *Çertifikata e bashkësisë familjare;*
3. *Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;*
4. *Fletëposedimi (original) për patundshmëri;*
5. *Çertifikata e regjistrimit të fermerit-NIF-i. (të jetë i/e regjistruar si fermer para publikimit të thirrjes për aplikim).*

Përparësitë:

Poena

- | | |
|---|------|
| 1. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit | 10 |
| 2. Aplikueset gra | 10 |
| 3. Fermerët të cilët janë kultivues të pemëve të imëta | 5 |
| 4. Numri i antarëve të familjes (1-5 antarë- 5 pikë); (mbi 5 antarë -10 pikë) | |
| 5. Vizita në terren | 0-50 |

Sqarim:

- Furnizimi me fidane të mjedrave do të bëhet nga vetë përfituesit, në etnitete që janë licencuar për prodhimin apo tregtimin e varieteteve të kërkuara të mjedrës;
- Furnizimi me sistem te ujitjes duhet të bëhet nga vet fermerët;
- Fidanet duhet të jenë të importuara nga BE;
- Përfituesit e fidaneve të mjedrës dhe sistemit të ujitjes duhet të kenë burimin e ujit;
- Mbjellja e fidaneve duhet të realizohet sipas kriterëve agroteknike;
- Pjesa tjetër e investimit të bëhet nga vetë fermerët;
- Përfituesi duhet të dorëzojë faturë të rregullt fiskale për blerjen e fidaneve dhe sistemit të ujitjes;
- Pagesa do të realizohet pas verifikimit nga organi kompetent komunal dhe konstatimit të përmbushjes së të gjitha kriterëve.

Koha dhe vendi i mbjelljes:

- Mbjellja e mjedrës duhet të bëhet në Pranverë.
- Kultivimi i mjedrës do të bëhet në tërë teritorin e Komunës së Podujevës.

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyren e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datë 16.04.2026 në ora 16:00

Nr: 12-320/01-0016997/26

Podujevë

24.03.2026



Drejtori i DBPZHR

Behram Latifi

Mars, 2026